URDHËR
Nr. 536, datë 27.9.2019

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË MENAXHIMIT TË NGJALËS EVROPIANE (*ANGUILLA ANGUILLA*) NË SHQIPËRI PËR PERIUDHËN 2019–2024

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102 të Kushtetutës, nenit 25, të ligjit nr.64, datë 31.5.2012 "Për peshkimin", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e planit të menaxhimit të ngjalës evropiane (*anguilla anguilla*), për periudhën 2019–2024, sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Bledar Çuçi

PLANI I MENAXHIMIT TË NGJALËS (*Anguilla anguilla*)

Tiranë, më 30.9.2019

HYRJE

Ngjala evropiane klasifikohet që nga viti 2009 si një "specie e rrezikuar në mënyrë kritike të zhdukjes" bazuar në opinionin e ICES (Këshilli Ndërkombëtar për Eksplorimin e Detit), i cili që në vitet 2000 konsideroi se kufijtë e sigurisë biologjike për këtë stok ishin tejkaluar. Bashkimi Evropian me miratimin e Rregullores së KE-së 1100/2007, ka detyruar shtetet anëtare që shfrytëzojnë stokun e ngjalës që të zvogëlojnë sforcon e peshkimit me 25% dhe të hartojnë një plan menaxhimi për ngjalën. Për më tepër, që nga viti 2009 ngjala evropiane përfshihet gjithashtu në shtojcën II të Konventës së Tregtisë Ndërkombëtare për Speciet e Rrezikuara të Faunës dhe Florës së egër (CITES), e cila ka të bëjë me speciet që nuk janë domosdoshmërisht në rrezik zhdukjeje, por për tregtimin e të cilave është planifikuar një kontroll, në mënyrë që të garantohet se ato nuk janë objekt i një shfrytëzimi të papajtueshëm me mbijetesën e tyre.

Nuk ka dyshim se të gjitha masat që miratohen në nivele të ndryshme kanë një ndikim të fortë në botën prodhuese, kryesisht në ekonomitë e peshkatarëve që veprojnë në ujërat e brendshme dhe lagunat bregdetare, të cilat, duke zbatuar rregulloret e miratuara, duhet të përshtaten me kufizimet e vendosura në drejtim të kufizimeve të periudhave të peshkimit, të pajisje dhe sasive.

Është e rëndësishme të theksohet se nëse konservimi i ngjalës është pjesë e problemit më të gjerë të menaxhimit të mjediseve ujore, gjendja e resursit nuk mundëson alternativa të tjera ndaj nevojës për të ndërhyrë urgjentisht në uljen e shkaqeve të vdekshmërisë për shkak të aktiviteteve të ndryshme njerëzore, përfshirë peshkimin. Duke pasur parasysh natyrën dhe kompleksitetin e problemit, me implikimet ekonomike që ai përfshin, është e nevojshme të përvetësohet një qasje shumëdimensionale për kërkimin e një modeli të qëndrueshëm të menaxhimit që gjithashtu merr parasysh implikimet shoqërore të lidhura me peshkimin.

Avantazhet e pritura nga kjo qasje, në shkallë kombëtare, janë përqendrimi i përpjekjeve të rimëkëmbjes të popullatave, për shembull, përmes zbatimit të planeve të ripopullimit në mjediset ku këto ndërhyrje mund të kontribuojnë në rritjen e popullsisë (në mungesë të vdekshmërisë së peshkimit ose kur kjo është e rregulluar) duke ruajtur përpjekjen aktuale të peshkimit në zona të tjera ujore ku ngjala është një nga burimet kryesore të të ardhurave për operatorët lokalë.

Ngjala evropiane (*Anguilla anguilla*) është një burim për të cilin është njohur gjerësisht nevoja për ndërhyrje dhe miratimin e masave që synojnë menaxhimin e popullatave, si dhe konservimin e saj. Në lidhje me rënien e zënieve dhe zvogëlimin e rekrutimit të vëzhguar në shkallë kontinentale, është shfaqur prej kohësh nevoja për të identifikuar një kornizë qëndrueshmërie për të gjitha aktivitetet e lidhura me shfrytëzimin e saj.

Shkalla e problemit duhet të konsiderohet në shkallën evropiane, pasi speciet përbëhen nga një stok i vetëm, individët e të cilit shpërndahen në fazën e rritjes në të gjithë kontinentin evropian, si dhe në brigjet veriore të Afrikës, për të riprodhuar më pas në të vetmin vend në detin e Sargaseve në oqeanin Atlantik. Karakteristikat e panmitisë së specieve dhe shfrytëzimi i gjerë i resursit, i cili është peshkuar në mënyra të ndryshme në rajone të ndryshme evropiane, dhe ka të bëjë edhe me fazat e të vegjëlve dhe ato para-të rriturve në sistemet e vetme hidrografike, qofshin ato liqene, laguna bregdetare apo sisteme lumenjsh, përcaktoi nevojën për një strategji transnacionale për të ruajtur stokun.

Këto konsiderata janë parakushtet e Rregullores së Këshillit 1100/2007, të 18 shtator 2007, e cila përcakton masa për rikuperimin e stokut të ngjalave evropiane. Kjo kërkonte që shtetet anëtare të BE-së të interesuara për ruajtjen e shfrytëzimit të stokut, dhe natyrisht dhe vendet e tjera Evropiane të përfshira në zënien e ngjalës, të miratojnë planet e menaxhimit të ngjalës që kanë për qëllim mbrojtjen dhe rivendosjen e stokut në nivel global.

Për këtë qëllim, ky Plan Kombëtar i Menaxhimit paraqet instrumentin që është identifikuar në nivel kombëtar, në mënyrë që edhe Shqipëria t'i bashkohet vendeve të tjera Evropiane, anëtare ose jo të BE, për shfrytëzimin e qëndrueshëm të resursit dhe të mund të marrë pjesë në procesin e rimëkëmbjes së popullatës.

Në drejtim të ruajtjes së stokut të ngjalës, objektivi kryesor këtij plani menaxhimi është lejim i një niveli të duhur të migrimit të ngjalave të argjendta nga secili pellgut lumor. Kjo duke marrë parasysh ciklin biologjik të specieve, rekrutimi natyror i të cilit varet nga emigrimi i riprodhuesve nga sistemet e vetme kontinentale në det dhe nga presionet antropogjene, përfshirë peshkimin, që kanë përcaktuar uljen drastike të biomasës totale të riprodhuesve.

Elementi kritik i këtij plani menaxhimi është të lejojë të paktën 40% të ngjalave të argjendta (faza e të rriturve që ndërmerr migrimin riprodhues) të kthehen në det, duke iu referuar kushteve të pacenuara, ose biomasës së ngjalave totale dhe emigrantëve ekzistues në zonat e ndryshme, përpara shfaqjes së ndikimeve njerëzore.

Ky plan menaxhimi është në përafrim dhe zbatim të Rregullores së Këshillit të 18 shtatorit 2007 nr. 1100/2007, që vendos masat për rindërtimin e stokut të ngjalës evropiane.

Kjo rregullore krijon një kornizë për mbrojtjen dhe përdorim të qëndrueshëm të stokut të ngjalës evropiane për specien *Anguilla anguilla* në ujërat e Bashkimit Evropian, në lagunat bregdetare, në grykëderdhjet, dhe në lumenjtë që komunikojnë me ujërat e brendshëm të

shteteve anëtare që rrjedhin në detet në zonat ICES III, IV,VI, VII, VIII, IX ose në detin Mesdhe.

Shtetet anëtare të BE-së duhet të identifikojnë dhe përcaktojnë basenet individuale të lumenjve që shtrihen brenda territorit të tyre kombëtar, që përbëjnë habitate natyrore për ngjalën evropiane, të cilat mund të përfshijnë ujërat detare.

Qëllimi i çdo Plani të Menaxhimit të Ngjalës duhet të jetë reduktimi i vdekshmërisë antropogjene në mënyrë që të lejojë me probabilitet të lartë largimin në det të paktën 40% të biomasës së ngjalës së argjendtë në krahasim me vlerësimin më të mirë të largimit të saj që do të kishte ekzistuar nëse nuk kishte ndikime antropogjene në stok. Plani i Menaxhimit të Ngjalës duhet të përgatitet me qëllim të arritjes së këtij objektivi në terma afatgjatë.

Miratimi i këtij plani menaxhimi për Shqipërinë është i nevojshëm për disa arsye:

1. Stoku i ngjalës në rang kombëtar është në rënie të theksuar gjatë 10-vjeçarit të fundit për çdo basen ujor

2. Ngjala evropiane është një stok i përbashkët dhe nevojitet një koordinim midis të gjitha vendeve evropiane.

3. Në kuadër të përafrimit të masave menaxhuese me Bashkimin Evropian.

Legjislacioni shqiptar parashikon si dimension minimal të zënies së ngjalës në 25 cm.

Me miratimin e planit të Menaxhimit të Ngjalës peshkimi për ngjalën e specieve *Anguilla anguilla* do të lejohet gjatë tërë vitit, me kusht që peshkimi të jetë në përputhje me specifikimet dhe kufizimet e përcaktuara në këtë Plan të Menaxhimit të Ngjalës.

KARAKTERIZIMI I MJEDISEVE UJORE TË IDENTIFIKUARA TË NGJALËS

Aktiviteti i peshkimit të ngjalës në Shqipëri kryhet në liqenin e Shkodrës dhe në lagunat bregdetare. Tetë lagunat kryesore bregdetare ndodhen në vijën bregdetare shqiptare me gjatësi prej rreth 430 km që përmban dy njësi gjeografike: zonat bregdetare të detit Adriatik dhe Jon. Shtatë prej tyre (nga veriu në jug; Viluni, Kune, Vain, Patok, Karavasta, Narta dhe Orikumi) janë vendosur në vijën bregdetare të detit Adriatik dhe vetëm një (laguna e Butrintit) ndodhet në vijën bregdetare të detit Jon.

Të dy detet kanë karakteristika mjaft të dallueshme fizike dhe kimike: Deti Adriatik tregon ndryshime të mëdha sezonale në temperaturë dhe produktivitet, me nivele të lëndëve ushqyese dhe kripëra të kontrolluara kryesisht nga inputet e ujërave të ëmbla. Në vend të kësaj, deti Jon ka një oqeanografi fizike dhe kimike më uniforme gjatë gjithë vitit.

Komuniteti i peshqve i lagunave bregdetare shqiptare është tipike për lagunat mesdhetare me dy grupe specie: peshku migrator dhe peshqit që qëndrojnë në laguna. *Sparidae, Mugilidae, Moronidae, Soleidae, Anguillidae, Belonidae* janë grupet kryesore të specieve migratore dhe *Gobiidae, Cyprinodontidae, Atherinidae, Syngnthidae* janë grupet kryesore me speciet që qëndrojnë në laguna, megjithëse disa lloje të këtyre grupeve janë gjithashtu migratore. Siç përshkruhet për secilën lagunë (shiko tabelën e specieve kryesore të peshkut për secilën lagunë), ekzistojnë disa dallime në speciet e peshkut, dhe speciet kryesore të peshkut janë: Sparus auratus, Mugil spp (*Mugil cephalus, M. ramada, M. saliens, Chelon Labrosus), Anguilla anguilla, Dicentrarchus labrax, Solea vulgaris, Atherina boyeri, Syngnathus spp.*

Në këto kategori ujore përdoren llojet e ndryshme të mjeteve të peshkimit si: pinarët për kapjen e të gjitha llojeve të peshkut, veçanërisht për ngjalat; mrezhat dhe njicat për qefujt, kocen dhe levrekun dhe grepat për ngjalat dhe kurthet për qefujt. Në kanalet e komunikimit të tyre me detin peshkimi praktikohet peshkimi me dajlan i vendosur në kanalin që lidh lagunën ose liqenin me detin.

Peshkimi në lagunat bregdetare kryhet nëpërmjet parancave, të cilat të vendosura në rresht njëra pas tjetrës krijojnë pinarët.



Figura 1. Parancat



Figura 2. Zonat e aktivitetit të peshkimit të ngjalës

LIQENI I SHKODRËS

Liqeni i Shkodrës ndodhet në pjesën perëndimore të Ballkanit, në kufi midis Shqipërisë dhe Malit të Zi, ndërmjet 42°21‟54”” dhe 19°09‟52”” në veri (Malo Blato, Sinjac), 42°0315”” dhe 19°30‟00”” në jug (burimi i Bunës), 42°0315”” dhe 19°30‟00”” në lindje (afër Shkodrës),

42°21‟19‟‟ dhe 19°01‟28‟‟ (afër Rijeka Crnojevica). Pellgu ujëmbledhës i liqenit të Shkodrës ka një sipërfaqe prej 5179 km², nga të cilat 1027 km² janë pjesë e territorit Shqiptar.

Liqeni i Shkodrës ndahet midis Shqipërisë (1/3) dhe Malit të Zi (2/3). Ai është relativisht i cekët, me thellësi mesatare 8 m, ndërsa baseni qendror arrin 45 m thellësi, ndërsa në burimet nën sipërfaqësore në Mal të Zi arrin deri në 90 m thellësi. Rreth 50 burime të tilla nën sipërfaqësore furnizojnë liqenin me ujë të pastër. Burimi kryesor i ujërave që vijnë nga sipërfaqja është lumi Moraça në Mal të Zi. Në anën lindore dhe veriore të liqenit rajonet rrethuese me pjerrësi të ulet sjellin përmbytje sezonale duke krijuar moçalishte të përhershme. Zona malazeze e liqenit dhe e moçalishteve që formon Parkun Kombëtar të liqenit të Shkodrës konsiderohet edhe qendër Ramsar. Sipërfaqja e liqenit të Shkodrës ndryshon çdo vit në vartësi nga sasia e reshjeve dhe lëviz nga 379 në 530 km².

Zonat kryesore në pellgun ujëmbledhës të liqenit të Shkodrës janë fushat e Nikshiqit dhe Cetinës, ultësira e Zeta – Shkodër, lumi Moraça me degët e tij (Zeta dhe Cemi), Përroi i Thatë me degët e tij, si dhe disa zona të tjera më të vogla, si lugina e Crnojevica dhe lugina e Rrjollit. Lartësia mesatare e pellgut ujëmbledhës është 770 m, që tregon se liqeni mbledh ujëra nga malet përreth. Lartësitë mbi nivelin e detit variojnë nga 5 m në ultësirën e Mbishkodrës, deri në 1490 m mbi nivelin e detit pranë burimit të Moraçës.

Zona përreth liqenit të Shkodrës përfshin një popullsi prej 500.000 banorë në Shqipëri dhe Mal të Zi. Rreth 65% e kësaj popullsie i përket Shkodrës dhe Podgoricës, ndërkohë që pjesa tjetër qyteteve të vogla si Koplik dhe Bajzë në Shqipëri, komunave të Nikshiqit, Cetinës dhe Tivarit në Mal të Zi, si dhe shumë fshatrave rreth liqenit.

Krahas Shqipërisë dhe Malit të Zi, liqeni i Shkodrës është, gjithashtu, i rëndësishëm në një aspekt më të gjerë rajonal. Ai është një rezervë e rëndësishme për biodiversitetin dhe një rrugë migruese për shumë lloje kafshësh të rajonit. Kjo zonë përfaqëson gjithashtu vlera të veçanta në aspektin hidrologjik dhe ekologjik, duke pasur parasysh lidhjen e liqenit të Shkodrës me një rrjet të gjerë hidrologjik në Ballkan nëpërmjet lumit Drin (liqeneve të Ohrit dhe Prespës) dhe me detin Adriatik nëpërmjet lumit Buna.

Shkodra, me rreth 115 000 banorë është qyteti më i madh në bregun e liqenit, ndërsa tri fshatrat më të mëdhenj që merren me peshkim janë: Kopliku, Shiroka dhe Zogaj. Dalje e liqenit është Buna që kalon afër qytetit të Shkodrës. Rrjedhja e poshtme e Bunës shërben si kufi midis Shqipërisë dhe Malit të Zi. Disa specie të peshqve që tregtohen migrojnë nga deti nëpër Bunë me rrjedhje të ngadaltë duke hyrë në liqen. Aktualisht më e rëndësishmja nga këto është ngjala.

Në liqen gjenden mbi 10 lloje peshqish me një farë rëndësie menaxhimi (tabela 1) speciet kryesore janë gjuca, krapi zakonshëm dhe ngjala. Kapen, gjithashtu, sharroku dhe disa specie të tjera, por në sasi më të pakta. Gjuca lëshon vezët në prill–maj. Ajo është një specie pelagjike, që ushqehet kryesisht me zooplankton. Krapi që jeton përgjatë fundit të liqenit dhe që ushqehet me invertebratë, si dhe me disa lëndë bimore, i lëshon vezët në prill–maj. Deri para viteve 90 në liqen zbatohej një plan ripopullimi m krap dhe peshqit e familjes së krapit (ballëgjerë, amur etj.) por kjo veprimtari tashmë është ndërprerë.

Në pjesën malazeze të liqenit kryhen disa veprimtari të pakta të akuakulturës bazuar në prodhimin e troftës ylber (*Onchorhynchus mykiss*) në rezervate me rrjeta. Deri tani në shumë pak raste mund të kenë shpëtuar trofta dhe të kenë hyrë në liqen. Ekzistenca e kësaj forme të akuakulturës përbën një farë shqetësimi, megjithëse këto specie mund të mos jenë në gjendje të shtohen në liqen. Liqeni i Shkodrës nuk ka habitatin (mjedisin) e përshtatshëm për salmonidet. Salmonidet e liqenit (*Salmo marmoratus*) që gjendeshin më parë në liqen, lëshonin vezët e tyre në lumenjtë që derdheshin në liqen, të cilët nga rregullimi i ujërave dhe nga ndotja janë bërë të papërshtatshëm. Kjo specie tashmë është shumë e rrallë. Megjithatë gjatë vitit 2014, janë identifikuar të vegjël të troftës së liqenit në zonën malazeze, në derdhjen e lumit Moraca në liqen. Ky përbën një lajm të mirë për liqenin dhe statusin e zonës.

Ka informacione mbi prezencën e luciperkës (*Stizostedion lucioperca*), i cili mendohet se ka hyrë në liqen përmes ujëmbledhësit të Vaut të Dejës nëpërmjet Komanit nga liqeni i Fierzës. Në qoftë se ky informacion konfirmohet dhe kjo specie grabitqare është vendosur në liqen, ekosistemi i

liqenit të Shkodrës do të pësojë ndryshime të mëdha pasi kjo specie shfrytëzon gjuhcën për ushqim.

Figura 3: Shtrirja e liqenit të Shkodrës

Disa specie katodrome (*catadromous*) (d.m.th. që migrojnë nga deti drejt ujërave të ëmbla) tradicionalisht hyjnë në liqen nëpërmjet Bunës për të lëshuar vezët ose për ushqim. Bllokimi i lumit nga mjete peshkimi apo bllokimi i rrjedhjes të lumit me punime infrastrukture apo veprimtari të tjera të njeriut, si dhe nga ndotja, kanë pakësuar shumë këto specie në liqen. Kështu ngjala hyn në lumë dhe në liqen në formën e rasateve (qelqoreve) të vogla dhe kapet nga peshkimi kur kthehet e rritur në det. Prandaj pak ndikojnë instrumentet e peshkimit që përqendrohen në peshkun që migron në ngjitje në grykën e lumit.

Lumi Buna

Lumi i Bunës rrjedh nga liqeni i Shkodrës në pjesën jugperëndimore të tij. Ka një gjatësi prej 44 km dhe është i vetmi lum fushor dhe emisari i liqenit nga ku buron. Buna bashkohet me lumin Drin rreth 1.5 km pasi del nga liqeni dhe që nga fshati Samrisht shërben si kufi shtetëror me Malin e Zi. Prurjet shumëvjeçare të Bunës në dalje nga liqeni i Shkodrës janë 320 m^3/sek dhe mbasi bashkohet me lumin Drin ato arrijnë vlerën 680 m^3/sek. Lumi i Bunës ka arritur nivel maksimal të plotave prej 7500 m^3/sek duke përmbytur sipërfaqe të mëdha toke. Në dekadat e fundit në pakësimin e përmbytjeve dhe të pasojave të tyre luajnë rol tri digat e hidrocentraleve të ndërtuara në lumin Drin. Derdhja e lumit Drin shpesh herë pengon shkarkimin e ujërave të liqenit të Shkodrës, si dhe ndonjë herë shfaqet dukuria e rrjedhjes me drejtim kundërt e lumit të Bunës. Për shkak të pjerrësisë së vogël dhe prurjeve të ngurta të Drinit shtrati i Bunës ka ndryshuar shpesh duke formuar meandre. Buna në det përfundon me një deltë natyrale që është e përbërë nga disa ishuj aluvionalë, si ishulli i Adës, Franc Jozefi etj. Lumi i Bunës në dalje të liqenit të Shkodrës ka një pellg ujëmbledhës prej 5187 km^2, ndërsa kur bashkohet me lumin Drin ka një sipërfaqe prej 19582 km^2.

Liqeni i Shkodrës luan një rol të rëndësishëm në regjimin e Bunës duke shërbyer si rregullator i prurjeve të saj. Kjo e bën një nga lumenjtë me regjim relativisht më të rregullt të Shqipërisë, prurjet e së cilit pësojnë luhatjet më të vogla në krahasim me gjithë lumenjtë e tjerë të mëdhenj të Shqipërisë.

Në lumin Buna gjenden mbi 30 lloje peshqish të ujërave të ëmbla ndër të cilët përmendim krapin (*Cyprinus carpio*), karasin (*Carassius auratus*), gjuhcën (*Alburnus alburnus alborella*), njilën (*Chondrostoma nasus ohridanus*), skortin e zi (*Pachychilon pictum*), lloskën (*Scardinius erythrophtalmus scardafa*), mlyshin (*Leuciscus cephalus albus*), sharmakun (*Perca fluviatilis*), barburiqin (*Blenius fluviatilis*) etj. Lumi është rrugë kalimi i peshqve të cilët migrojnë nga deti në liqenin e Shkodrës e anasjelltas. Janë 13 lloje peshqish migratorë nga të cilët përmendim blini (*Acipenser sturio*) që është lloj i rrezikuar globalisht, kublën (*Allosa fallax nilotica*), ngjala (*Anguilla anguilla*), levreku (*Dicenthrarchus labrax*), qefullin e verës (*Mugil cephalus*), qefullin e vjeshtës (*Liza ramada*), shojzën (*Platichthys flesus luscus*) etj. Në grykëderdhjen e Bunës ka mbi 50 lloje të tjerë peshqish ku përmendim açugën (*Engraulis encrasicholus*), çeliku (*Aphianus fasciatus*), gjilpërëza turi gjatë (*Syngnathus tenuirostris*), korbi i zi (*Sciaena umbra*), korbi i bardhë (*Umbrina cirrosa*), sargoi (*Diplodus sargus sargus*), murra (*Lithognathus mormyrus*) aterina (*Atherina hespetus*), gjuhëza e Adriatikut (*Solea vulgaris*) etj.

Buna është e pasur me lloje të ndryshme shpendësh ku janë numëruar rreth 50 lloje shpendësh dhe bën pjesë në një nga tri rrugët e migrimit të shpendëve të Evropës. Një pjesë e llojeve të shpendëve që vëzhgohen janë migratore dhe folezues në këtë zonë. Ndër to përmendim ato lloje që kanë numrin më të madh të individëve si kredharaku i vogël (*Tachybaptus ruficollis*), karabullaku i vogël (*Phalacrocorax pygmeus*), kryekuqja e madhe (*Anas penelope*), rosa e vendit (*Anas platyrhynchos*), rosa sqeplugë (Anas clypeata), rosa kërre (*Anas crecca*), kryekuqja e mjerme (*Aythya ferina*), rosa me katër sy (*Bucephala clangula*), bajza (*Fulica atra*), cinja (*Vanellus vanellus*), pulëbardha e zakonshme (*Larus ridibunda*), pulëbardha e vogël (*Larus minutus*), dallëndyshja e detit (*Sterna sandvicensis*), laraska e detit (*Haematopus ostralegus*), gjelaci symadh (*Burhinus oedicnemus*), kalorësi (*Himantopus himantopus*), sqep biza (*Recurvirostra avosetta*), bisht dallëndyshja (*Glareola pranticola*), vrapuesi gushëbardhë (*Charadrinus alexandrinus*), dallëndyshja e vogël e detit (*Sterna hirundo*) etj.

STATUSI MJEDISOR I ZONËS

Në Malin e Zi që nga viti 1983 liqeni i Shkodrës është shpallur Park Kombëtar (kategoria e dytë e menaxhimit sipas IUCN). Në vitin 1995 Parku Kombëtar i liqenit të Shkodrës u shpall zonë Ramsar (sipërfaqe ligatinore e rëndësisë së veçantë). Parku kombëtar ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 40.000 ha.

Në Shqipëri statusi aktual i mbrojtjes së liqenit të Shkodrës është "Rezervat Natyror i Menaxhuar" (kategoria IV sipas IUCN), shpallur nga qeveria shqiptare me vendim nr. 684, datë 2.11.2005.

Rezervati natyror i menaxhuar i liqenit të Shkodrës, kufizohet:

Nga veriu: me pikën kufitare "Hani i Hotit" (420 20'17" 190 26');

Nga perëndimi: me kufirin shtetëror të Republikës së Shqipërisë me Republikën e Mali të Zi;

Nga lindja: me rrugën kombëtare automobilistike Shkodër–Hani i Hotit;

Nga jugu: me vijën që bashkon grykëderdhjen e liqenit të Shkodrës me pikën kufitare (koordinatat: 420 04'18" 190 23', 420 03'08" 190 29'30").

3. Rezervati natyror i menaxhuar i liqenit të Shkodrës ka një sipërfaqe të përgjithshme 26 535 ha, të përbërë nga:

- sipërfaqe ujore 15 719 ha;
- sipërfaqe pyjore e shkurrore 1965 ha;
- të tjera 8851 ha.

Zona e mbrojtur në pjesën shqiptare ndahet në tri kategori:

a) Zona qendrore (e paraqitur në hartën që i bashkëlidhet Vendimit me"1/a") e përbërë nga: bregu i liqenit, që fillon nga pika ekstreme perëndimore e fshatit Zogaj deri në kufirin midis dy Republikave, Shqipëri–Mal i Zi, shpati i Malit Tarabosh nga lartësia 494 m në jug, deri në 200 m në brendësi të ujërave të liqenit në segmentin ndërkufitar Zogaj–Shqipëri–Mal i Zi në veri. Në këtë zone aplikohet niveli i dytë i mbrojtjes.

b) Zonë e habitateve të menaxhuara (e paraqitur në hartën që i bashkëlidhet vendimit me 2/a) e përbërë nga: gjithë sipërfaqja ujore e liqenit, përjashtuar zona e përfshirë në 1/a e përmendur më sipër; bregu perëndimor shqiptar nga ura e Bunës në lindje, në fshatin Zogaj në perëndim

(duke rrethuar zonën 1/a të kësaj pike) duke përfshirë gjithë lartësitë e këtij segmenti deri në 300 m në shpatin e Malit Tarabosh në jug. Në këtë zone aplikohet niveli i tretë i mbrojtjes.

c) Zonë e zhvillimit tradicional (e paraqitur në hartën që i bashkëlidhet vendimit me 3/a) e përbërë nga: e gjithë sipërfaqja lindore e liqenit, kufizuar në perëndim me zonën 2/a të përmendur më sipër, deri në rrugën Shkodër–Hani i Hotit në lindje dhe qytetin e Shkodrës në fundin juglindor. Në këtë zonë aplikohet niveli i katërt i mbrojtjes.

Zona liqenore në pjesën shqiptare është shpallur edhe zonë Ramsar (Konventa e Ramsarit "Ligatinat me rëndësi ndërkombëtare, veçanërisht si habitate për shpendët ujore") me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 683, datë 2.11.2005.

STATUSI I PESHKIMIT I ZONËS

Në liqenin e Shkodrës zhvillon aktivitetin e saj Organizata e Menaxhimit të Peshkimit (OMP), liqeni i Shkodrës. OMP-ja liqeni i Shkodrës është ngritur me urdhrin e MBU-së nr. 17/2, datë 21.5.2003 "Për miratimin e Statutit të Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit (OMP-ja liqeni i Shkodrës)". Me njohjen e OMP-së liqeni i Shkodrës, ky liqen ka marrë statusin e zonës së bashkëmenaxhimit. OMP-ja liqeni i Shkodrës është themeluar më 23 mars 2003, dhe ministri miratoi statusin ligjor të kësaj organizate më 21 maj 2003. Në pjesën shqiptare të liqenit të Shkodrës është edhe dajlani i Shkodrës, i cili ka një status të dyfishtë. Kjo organizatë është e pajisur me kontratë për ushtrimin e aktivitetit në fushën e peshkimit me nr. 6042, të prot. datë 2.8.2016, me afat 10-vjeçar, bazuar në VKM-në nr. 469, datë 22.6.2016 "Për shpalljen e liqenit të Shkodrës dhe lumit Buna si zonë bashkëmenaxhuese peshkimi". OMP-të janë organizata me struktura private ligjore të pavarura, janë jofitimprurëse dhe të gjithë të ardhurat e saj përdoren për funksionimin e organizatës dhe për përmbushjen e objektivave të saj. OMP-ja merr pjesë aktive në menaxhimin e liqenit, kjo dhe për faktin se lejet e peshkimit i lëshohen vetëm anëtarëve të OMP-së.

Gjuetia e ngjalës në këtë zonë kryhet nëpërmjet peshkimit artizanal me paranca (me rreth 25 paranca) dhe me rreth 1000 grepa (nga 50 grupe peshkimi).

Tabela 1. Emrat e zakonshëm dhe shkencorë të peshqve të liqenit të Shkodrës dhe përqindjet e zënies së tyre

Speciet **Emri anglisht**	**Emri shqip**	**Emri shkencor**	**Përqindja**
Speciet e liqenit			
Bleak	Gjuca, Ciron	Alburnus albidus alborella	21.73%
Common carp	Krap	Cyprinus carpio	27.86%
Crucian carp	Karasi	Carassius	10.72%
Roach	Gurnec	Rutilus rubilio	32.31%
Mullet	Qefulli	Mugil cephalus	5.23%
European eel	Ngjala	Anguilla	1.17%
Alosa	Kubla	Alosa fallax	0.27%
Perch	Sharroku	Perca fluviatilis	0.72%
Sturgeon	Blini	Acipenser sturio	0%

Burimi: OMP-ja liqeni i Shkodrës, 2009–2019

Tabela 2. Zëniet e ngjalës sipas formave të peshkimit në vite (burimi: OMP-ja liqeni i Shkodrës)

Viti	**Zëniet sipas formës së peshkimit (ton)/ numri i mjeteve të peshkimit**			**Prodhimi total vjetor (ton)**	**Prodhimi në % sipas peshës së ngjalës (g)**		
	Dajlan	**Mjete fikse**			**80-100 g**	**100-300 g**	**Mbi 300 g**
		Paranca (25 paranca)	**Grepa (50 subjekte me 1000 grepa)**				

2013	1.4	3.7	0.4	5.5	5%	20%	75%
2014	1.4	3	1.1	5.5	3%	25%	72%
2015	0.8	N/A	N/A	0.8	-	20%	80%
2016	1	3	N/A	4	5%	20%	75%
2017	7.5	10	4	21.5	5%	20%	75%
2018	6	6.5	5	17.5	5%	20%	75%

LAGUNA E VILUNIT

Laguna e Vilunit. Laguna e Vilunit ndodhet në veri të Shqipërisë, 7 km në jug të grykës së lumit Buna dhe 10 km në veriperëndim të portit të Shëngjinit. Kufijtë e saj janë si më poshtë: në veri është fshati Velipojë, në lindje është fshati Bakshi i Ri, në jug është fshati Rrjoll dhe në perëndim është deti Adriatik.

Sipërfaqja (ha)	Gjatësia max (m)	Gjerësia max (m)	Thellësia max. (m)	Thellësia mesatare (m)
280	3500	2000	5	0,8

Shkëmbimi i ujit me detin bëhet përmes kanalit të hyrjes me detin 500 metra i gjatë dhe 30-40 m i gjerë. Në det, thellësia e ujit po rritet ngadalë duke arritur në izobatet 20m në 3 km nga bregu. Dy kanale kryesore kullimi sjell ujë të pasur me lëndë ushqyese në lagunën e Vilunit nga fusha bujqësore. Kanalet e kullimit shtrihen nga zona e nën Shkodrës, duke hapur kanalin e lagunës në grykën e komunikimit me detin.

Laguna e Vilunit, si pjesë e kompleksit ligatinor të bregdetit verior shqiptar, ka origjinën e tij nga veprimtaria aluvionale e depozitimit të lumit Buna. Produktet e sedimentimit të sjella nga lumi Buna janë transportuar dhe janë vendosur në deltën e lumit Buna. Lumi Buna është mbushur intensivisht me depozita aluvionale, të cilat kanë hyrë thellë në det. Depozitat e diferencuara të aluvioneve dhe lidhjet e tyre me bregdetin me rërë masive kanë krijuar një labirint të formave të ngjashme me: shigjeta, harqe dhe shtigje ranore që kanë hyrë në det duke krijuar lagunën.

Tabela 3. Emrat e zakonshëm dhe shkencorë të peshqve të lagunës së Vilunit

Emri anglisht	Emri shqip	Emri shkencor
Flathead grey mullet	Gushtak; Qefull vere; Cumër	Mugil cephalus
Thicklip grey mullet	Vijoshi; Vruta	Chelon labrosus
Thinlip mullet	Qefulli i vjeshtës; Kokllani; Kryegjati	Liza ramada
Leaping mullet	Vesh verdhi; Gasturi	Liza saliens
European seabass	Levrek	Dicentrarchus labrax
European eel	Ngjalë	Anguilla anguilla
Gilthead seabream	Koce	Sparus aurata
Bogue	Vope	Bops bops
White seabream	Sargua, Shpalcë	Diplodus sargus sargus
Common sole	Gjuhëz kanali; Shojze	Solea vulgaris
Mediterrenean sand smelt	Aterina	Atherina hepsetus
Pipefish	Gjilpërëza	Syngngathus sp
Buccich's goby	Burdullak	Gobius bucchichi

Burimi: Ihktiofauna e Shqipërisë (prof. Ndoc Rakaj, Aleksandër Flloko "Libri Universitar", Tiranë 1995)

STATUSI MJEDISOR I ZONËS

Laguna e Vilunit është peizazh i mbrojtur bazuar në VKM-në nr. 682, datë 2.11.2005 "Për shpalljen e lumit Buna dhe të territoreve ligatinore përreth tij "peizazh ujor/tokësor i mbrojtur".

Peizazhi ujor/tokësor i mbrojtur kufizohet:

Nga Veriu: Me vijën që bashkon daljen e lumit Buna nga liqeni i Shkodrës deri në kufirin verior me Republikën Serbi–Mali i Zi (koordinatat 420 03'08" 190 29'30", 420 01'31" 190 29', 420 00'36" 190 25'7", 420 00' 190 23'45");

Nga Perëndimi: Me vijën e kufirit shtetëror përgjatë lumit Buna me Republikën Serbi-Mali i Zi;

Nga Lindja: Me vijën që bashkon daljen e lumit Buna nga liqeni i Shkodrës deri te Rëra e Hedhur dhe që kalon nga zona malore (koordinatat: 410 50'30" 190 35'30", 420 53'15" 190 30', 410 59'30" 190 31'30", 420 00' 190 31'33", 420 02'15" 190 30', 420 03'08" 190 29').

Nga Jugu: Me vijën bregdetare nga Rëra e Hedhur deri te grykëderdhja e lumit Buna (koordinatat: 410 50'57" 190 23', 410 51'28" 190 27'30", 410 50'58" 190 30'. Peizazhi ujor/tokësor i mbrojtur i lumit Buna ka një sipërfaqe të përgjithshme 23 027 ha, të përbërë nga:

a) sipërfaqe pyjore dhe shkurrore, 7 799 ha;

b) sipërfaqe lagunore, 346 ha;

c) duna ranore, bregdetare, 496 ha;

ç) toka të kripura, 252 ha;

d) sipërfaqe të tjera (toka bujqësore, zona të banuara), 14 134 ha.

Peizazhi ujor/tokësor i lumit Buna ka zonimin e mëposhtëm:

Zona qendrore (zona A)

A.1 Zonë qendrore e përbërë nga:

a) pjesa e lumit Buna dhe brigjet e tij nga bashkimi me lumin Drin deri në fshatin Obot;

b) brigjet e lumit Buna në pjesën perëndimore të rezervatit të Velipojës, nga grykëderdhja e lumit deri përballë skajit verior të ishullit Ada dhe 200 m në brendësi të rezervatit në lindje;

c) ishulli i Franc Jozefit dhe bregdeti në lindje të grykëderdhjes, në gjatësi deri 2 km dhe gjerësi 300 m në det, drejt jugut;

d) ç) pjesa qendrore dhe veriore e lagunës së Vilunit;

e) gadishulli në plazhin e Baks–Rrjollit dhe një gjerësi 300 m në jug të vijës bregdetare deri te Rëra e Hedhur;

dh) pjesa qendrore e kënetave të Domnit dhe të Murtemzës.

Në këtë zonë të zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes, në mbështetje të ligjit nr. 8906, datë 6.6.2002, "Për zonat e mbrojtura".

STATUSI I PESHKIMIT I ZONËS

Në lagunën e Vilunit, ushtrohet aktivitet peshkimi artizanal lagunor me dajlan dhe me mbrezhda, njica, grepa e pinar, me 3 grupe gjuetie peshku, me barka peshkimi me motor foribord me rreth 10 peshkatarë.

Për kryerjen e aktivitetit të peshkimit artizanal me rrjeta peshkimi, janë angazhuar 3 grupe gjuetie peshku me rreth 6 peshkatarë që ushtrojnë aktivitet peshkimi gjithëvjetor.

Këto grupe peshkimi, përdorin kryesisht rrjeta të tipit mbrezhda e njica, rreth 15–20 copë për çdo grup gjuetie (1 mrezhde/njice ka gjatësinë rreth 50–60 ml), pra do të përdoren rreth 3000–3600 ml rrjeta gjuetie. Gjithashtu, këto grupe peshkimi përdorin dhe rreth 500 grepa peshkimi.

Aktivitetin e peshkimit artizanal me dajlan e kryejnë aktualisht 2 grupe peshkimi me 1 dajlan (për periudhën 1 tetor–14 mars të çdo viti). Në dajlan punojnë 4 peshkatarë (2 turne x 2 peshkatarë).

Gjuetia e ngjalës në këtë zonë kryhet nëpërmjet peshkimit artizanal me paranca (me rreth 150 paranca).

Tabela 4. Zëniet e ngjalës sipas formave të peshkimit në vite

Viti	Zëniet sipas veglës të përdorur (ton)				Zëniet sipas dimensioneve (g)		
	Dajlan	Paranca	Grepa	Totali	80-100	100-300	>300

2013	0,89	2,90	0	3,8	35%	55%	10%
2014	0,64	2,62	0	3,3	35%	55%	10%
2015	1,30	3,30	0	4,6	35%	55%	10%
2016	0,75	2,84	0	3,6	35%	55%	10%
2017	0,60	1,70	0	2,3	35%	55%	10%
2018	0,68	2,40	0	3,1	35%	55%	10%
Totali	**4,86**	**15,77**	**0**	**20,6**			



KOMPLEKSI LAGUNOR KUNE-VAIN

Laguna e Vain ndodhet në jug të lumit Drini dhe është një nga komplekset e lagunës Kune–Vain. Ndodhet 70 km larg nga Tirana, kryeqyteti i vendit dhe 45 km larg nga liqeni i Shkodrës, pranë kufirit me Jugosllavinë, 20 km në perëndim të qytetit të Lezhës dhe në veri të grykës së lumit Drin. Kufijtë e tij janë në veri të lumit Drin, në lindje fshatrat e ishullit Lezhë dhe Rrile, në jug kanali i rrjedhjes së ujërave të larta dhe në perëndim deti Adriatik. Sipërfaqja e lagunës është 850 ha. Përfshihet në zonën e ligatinës M2 midis paralelit 41^0 dhe 30" dhe 19^0 dhe 30".

Sipërfaqja (ha)	Gjatësia max (m)	Gjerësia max (m)	Thellësia max. (m)	Thellësia mesatare (m)
850	4400	2950	4,5	0,7

Laguna e Vain ka origjinën e tij nga aktivitetet tektonike dhe aktiviteti depozitues aluvional i lumenjve Drin dhe Mat. Sedimenti i imët është transportuar nga ujërat e rrjedhës dhe janë vendosur në shtratin e detit dhe deltën e lumenjve. Delta e lumit Drin është e mbushur intensivisht me depozita aluvionale, ndërsa në veri dhe lindje kjo zonë është e rrethuar nga zona malore të larta me origjinë nga formimi Mesozoik dhe paleogjenetik. Më tej tektonika e fortë gjatë kuartenarit, veçanërisht ndryshimi i shtratit të lumenjve shkaktoi formimin e pellgjeve të lidhura në mënyrë periodike ose të përhershme me detin, duke ndryshuar kështu vazhdimisht vijën e bregdetit. Depozitat e diferencuara të aluvioneve dhe lidhjet e tyre me bregdetin me rërë masive kanë krijuar një labirint të formave të ngjashme me shigjeta, harqe dhe shtigje me rërë.

Kanali lidhës me detin është i gjatë 1800 m, rreth 30 m i gjerë dhe maksimumi i thellë 1 m. Kjo lagunë nuk ka një shkëmbim të qëndrueshëm të ujit me detin për shkak të mbylljes së grykës së kanalit të hyrjes – kanalit të detit nga depozitimi i rërës. Puset arteziane janë gjithashtu përbërës të ekuilibrit të ujit të lagunës Vain. Ka 9 puse të tilla, që kanë shkarkimin Q = 5-6 l/s.

Tabela 5. Emrat e zakonshëm dhe shkencorë të peshqve të lagunës së Vainit

Emri anglisht	Emri shqip	Emri shkencor
Flathead grey mullet	Gushtak; Qefull vere; Cumër	Mugil cephalus

Thicklip grey mullet	Vijoshi; Vruta	Chelon labrosus
Thinlip mullet	Qefulli i vjeshtës; Kokllani; Kryegjati	Liza ramada
Leaping mullet	Vesh verdhi; Gasturi	Liza saliens
European seabass	Levrek	Dicentrarchus labrax
European eel	Ngjalë	Anguilla anguilla
Gilthead seabream	Koce	Sparus aurata
Bogue	Vope	Bops bops
White seabream	Sargua, Shpalcë	Diplodus sargus sargus
Common sole	Gjuhëz kanali; Shojze	Solea vulgaris
Mediterranean sand smelt	Aterina	Atherina hepsetus
Pipefish	Gjilpëreza	Syngngathus sp
Buccich's goby	Burdullak	Gobius bucchichi

Burimi: Ihktiofauna e Shqipërisë (Ndoc Rakaj, Aleksandër Flloko "Libri Universitar", Tiranë, 1995)

STATUSI I PESHKIMIT I ZONËS

Në lagunën e Vainit (me nënndarjet zona lagunore Zaje dhe zona lagunore Ceke), për kryerjen e aktivitetit të peshkimit artizanal me rrjeta peshkimi, janë angazhuar 8 grupe gjuetie peshku me rreth 16 peshkatarë, me tetë barka peshkimi. Këto grupe peshkimi, përdorin kryesisht rrjeta të tipit mbrezhda e njica, rreth 6–10 copë për çdo grup gjuetie (1 mbrezhdë/njice ka gjatësinë rreth 50-60 ml), pra përdoren rreth 5000 ml rrjeta gjuetie.

Aktivitetin e peshkimit artizanal me dajlan e kryejnë aktualisht dy subjekte peshkimi me dy dajlanë (për periudhën 1 gusht–9 mars të çdo viti). Në dajlanin e lagunës së Cekës punojnë rreth nëntë peshkatarë, ndërsa në lagunën e Zajes mbi lumin Drin punojnë tre peshkatarë, me tri turne.

Peshkimi i ngjalës në këtë lagunë bëhet në formën e peshkimit artizanal me dajlan dhe në formën e peshkimit artizanal me paranca. Për këtë të fundit, përdoren rreth 70 paranca për kapjen e ngjalës.

Tabela 6. Zëniet e ngjalës sipas formave të peshkimit në vite

Viti	**Zëniet sipas veglës të përdorur (ton)**				**Zëniet sipas dimensioneve (g)**		
	Dajlan	**Paranca**	**Grepa**	**Totali**	**80-100**	**100-300**	**>300**
2013	3,7	4,2	0,00	7,91	35%	55%	10%
2014	3,5	3,3	0,00	6,80	35%	55%	10%
2015	3,4	4,5	0,00	7,90	35%	55%	10%
2016	4,1	4,3	0,00	8,43	35%	55%	10%
2017	3,7	1,5	0,00	5,16	35%	55%	10%
2018	6,4	5,2	0,00	11,64	35%	55%	10%
Totali	**24,83**	**23,00**	**0,00**	**47,83**			



Laguna e Kune, si pjesë e kompleksit të lagunës Kune–Vain, ndodhet në anën veriore të lumit Drin. Kufijtë e tij janë në veri të qytetit të Shëngjinit, në lindje fshatin Ishulli Shëngjini, në jug lumi Drin dhe në perëndim deti Adriatik.

Ndodhet 70 km larg nga Tirana, kryeqyteti i vendit dhe 45 km larg liqenit të Shkodrës, afër kufirit me Jugosllavinë, 20 km në perëndim të qytetit të Lezhës dhe në veri të rrjedhës së lumit Drin.

Sipërfaqja (ha)	Gjatësia max (m)	Gjerësia max (m)	Thellësia max. (m)	Thellësia mesatare (m)
250	5800	950	5	1

Sedimenti i imët është transportuar nga ujërat e rrjedhës dhe janë vendosur në shtratin e detit dhe deltën e lumenjve. Delta e lumit Drin është e mbushur intensivisht me depozita aluvionale, ndërsa në veri dhe lindje kjo zonë është e rrethuar nga zona malore të larta me origjinë nga formimi Mesozoik dhe paleogjenetik. Më tej tektonika e fortë gjatë kuartenarit, veçanërisht ndryshimi i shtratit të lumenjve shkaktoi formimin e pellgjeve të lidhura në mënyrë periodike ose të përhershme me detin, duke ndryshuar kështu vazhdimisht vijën e bregdetit. Depozitat e diferencuara të aluvioneve dhe lidhjet e tyre me bregdetin me rërë masive kanë krijuar një labirint të formave të ngjashme me shigjeta, harqe dhe shtigje me rërë, të cilat kanë hyrë në det duke krijuar lagunën dhe ishullin (ishulli Kune).

Gryka e shkëmbimit të ujit (kanali i hyrjes – deti) është 560 m i gjatë dhe 14–20 m i gjerë dhe maksimumi 3 m i thellë dhe kjo lagunë ka një shkëmbim relativisht të qëndrueshëm të ujit. Puset arteziane (burimet) janë, gjithashtu, përbërës të bilancit të ujit të lagunës së Kune. Ka 3 puse të tilla, që kanë shkarkimin Q = 5-6 l / s.

Tabela 7. Emrat e zakonshëm dhe shkencorë të peshqve të lagunës së Kunës

Emri anglisht	Emri shqip	Emri shkencor
Flathead grey mullet	Gushtak; Qefull vere; Cumër	Mugil cephalus
Thicklip grey mullet	Vijoshi; Vruta	Chelon labrosus
Thinlip mullet	Qefulli i vjeshtës; Kokllani; Kryegjati	Liza ramada
Leaping mullet	Vesh verdhi; Gasturi	Liza saliens
European seabass	Levrek	Dicentrarchus labrax
European eel	Ngjalë	Anguilla anguilla
Gilthead seabream	Koce	Sparus aurata
Bogue	Vope	Bops bops
White seabream	Sargua, Shpalcë	Diplodus sargus sargus
Common sole	Gjuhëz kanali; Shojze	Solea vulgaris
Mediterranean sand smelt	Aterina	Atherina hepsetus

Pipefish	Gjilpërëza	Syngngathus sp
Buccich's goby	Burdullak	Gobius bucchichi

Burimi: Ihktiofauna e Shqipërisë (Ndoc Rakaj, Aleksandër Flloko, "Libri Universitar", Tiranë, 1995)

STATUSI I PESHKIMIT I ZONËS

Në këtë lagunë (me nënzonat Gjoli i Knallës, Vija Kular dhe Merxhani), ushtrohet aktivitet peshkimi artizanal lagunor me dajlan, me mrezhda, njica e pinar dhe rrallë herë me grepa (rreth 500 copë), me 14 grupe gjuetie peshkimi me rreth 28 peshkatarë (nga të cilët 4 me punësim provizor).

Për kryerjen e aktivitetit të peshkimit artizanal me rrjeta peshkimi, janë angazhuar 8 grupe gjuetie peshku me rreth 12 peshkatarë që ushtrojnë aktivitet peshkimi gjithë vjetor dhe 2 me punësim provizor.

Këto grupe peshkimi, përdorin kryesisht rrjeta të tipit mrezhda e njica, rreth 6–8 copë për çdo grup gjuetie (1 mrezhde/njice ka gjatësinë rreth 50–60 ml), pra përdoren rreth 4 000–5 000 ml rrjeta gjuetie.

Aktivitetin e peshkimit artizanal me dajlan e kryejnë aktualisht gjashtë grupe peshkimi me tre dajlan (për periudhën 1 gusht–9 mars të çdo viti). Në 3 dajlanët punojnë 14 peshkatarë (3 turne x 4 peshkatarë), 2 nga këta peshkatarë të punësuar provizor.

Në këtë lagunë peshkimi i ngjalës nga grupet e peshkimit kryhet në formën e peshkimit me 3 dajlanët dhe në formën e peshkimit me paranca (rreth 300 paranca).

Tabela 8. Zëniet e ngjalës sipas formave të peshkimit në vite

Viti	Zëniet sipas veglës të përdorur (ton)			Zëniet sipas dimensioneve (g)			
	Dajlan	Paranca	Grepa	Totali	80-100	100-300	>300
2013	0,74	2,16	0,00	2,90	35%	55%	10%
2014	0,65	2,18	0,00	2,83	35%	55%	10%
2015	0,90	2,90	0,00	3,80	35%	55%	10%
2016	0,63	1,40	0,00	2,03	35%	55%	10%
2017	0,68	0,50	0,00	1,18	35%	55%	10%
2018	0,70	1,85	0,00	2,55	35%	55%	10%
Totali	4,31	10,99	0,00	15,30			



LAGUNA E PATOKUT

Laguna e Patokut është pjesë e ultësirës perëndimore të zonës mesdhetare të Shqipërisë përgjatë detit Adriatik, në perëndim të qytetit Laç. Ndodhet midis dy grykave të lumenjve Droj dhe Mat. Kufijtë e tij janë si më poshtë: në veri është lumi Mat, në jug lumi Droj dhe kanalizimet

e kullimit të kolektorit të ujit të Shëllinze, në lindje fshatrat Fushë-Kuqe dhe Adriatik dhe në perëndim detin Adriatik.

Sipërfaqja (ha)	Gjatësia max (m)	Gjerësia max (m)	Thellësia max. (m)	Thellësia mesatare (m)
260	3500	200	1,5	0,7

Laguna e Patokut e ka origjinën nga aktivitetet tektonike dhe energjia e lumenjve Droj dhe Mat. Shumë ndryshime në këtë lagunë kanë ndodhur për shkak të devijimit të pellgut të lumit Mat dhe ndërtimit të dy hidrocentraleve (Ulëz dhe Shkopet). Depozitat e diferencuara të aluvioneve dhe lidhjet e tyre me bregdetin me rërë masive kanë krijuar një labirint të formave si: shigjeta, harqe dhe shtigje ranore, të cilat kanë hyrë në det duke krijuar lagunën e re ("godulla") me një thellësi 1.5 metër. "Godulla" ndahet nga deti nga një istëm me rërë dhe në pjesën jug-perëndimore lidhet me detin 100 m, dhe në pjesën veriore dhe lindore lidhet me dy pjesë të lagunës.

Laguna ndahet nga një rrugë në dy pjesë, të cilat nuk komunikojnë, në lagunën e madhe dhe të vogël. Laguna e vogël ("Limani i vogël") është rreth 10 ha dhe ka një thellësi 50 cm me një pellg me baltë. Ndodhet rreth 80 m në jug të grykës së lumit Mat dhe lidhet me "godulla" me kanalin 100 m gjatësi dhe 3 m thellësi. Kjo pjesë e vogël nuk është e lidhur me pjesën e madhe. Pjesa e madhe ("Limani i madh") ka një sipërfaqe prej 250 ha, thellësia mesatare është 1 m dhe lidhet me godullën përmes një ure betoni.

Gjatësia mesatare e lagunës Patok është 3500 m. Gjerësia maksimale është 200 m dhe thellësia maksimale 1.5 m.

Tabela 9. Emrat e zakonshëm dhe shkencorë të peshqve të lagunës së Patokut

Emri anglisht	Emri shqip	Emri shkencor
Flathead grey mullet	Gushtak; Qefull vere; Cumër	Mugil cephalus
Thicklip grey mullet	Vijoshi; Vruta	Chelon labrosus
Thinlip mullet	Qefulli i vjeshtës; Kokllani; Kryegjati	Liza ramada
Leaping mullet	Vesh verdhi; Gasturi	Liza saliens
European seabass	Levrek	Dicentrarchus labrax
European eel	Ngjalë	Anguilla anguilla
Gilthead seabream	Koce	Sparus aurata
Bogue	Vope	Bops bops
White seabream	Sargua, Shpalcë	Diplodus sargus sargus
Common sole	Gjuhëz kanali; Shojze	Solea vulgaris
Mediterranean sand smelt	Aterina	Atherina hepsetus
Pipefish	Gjilpërëza	Syngngathus sp
Buccich's goby	Burdullak	Gobius bucchichi

Burimi: Ihktiofauna e Shqipërisë (Ndoc Rakaj, Aleksandër Flloko "Libri Universitar", Tiranë, 1995)

STATUSI I PESHKIMIT I ZONËS

Në lagunën e Patokut, zhvillohet kryesisht aktivitet familjar peshkimi, me veglat e peshkimit si mbrezhda, njica, dajlan, pinar, grepa. Tipi i gjuetisë është me rrethime, me mjete fikse (pinar, dajlan), me grepa, me një mesatare dite gjuetie rreth 14–18 ditë në muaj në kohën e gjuetisë.

Për kryerjen e aktivitetit të peshkimit artizanal me rrjeta peshkimi, janë angazhuar 4 grupe gjuetie peshku me rreth 20 peshkatarë që ushtrojnë aktivitet peshkimi gjithë vjetor.

Këto grupe peshkimi, përdorin kryesisht rrjeta të tipit mbrezhda e njica, rreth 3–4 copë për çdo grup gjuetie (1 mbrezhdë/njice ka gjatësinë rreth 50–60 ml), pra, përdoren rreth 1000–1500 ml rrjeta gjuetie.

Aktivitetin e peshkimit artizanal me dajlan e kryejnë aktualisht dy subjekte peshkimi me katër dajlanë (për periudhën 1 tetor–14 mars të çdo viti). Në çdo dajlan punojnë gjashtë peshkatarë (3 turne x 2 peshkatarë), tetë mjete lundruese me motor foribord, me një gjatësi mesatare që varion nga 4.5–6 m, shtatë mjete me material druri, një plastik, me nga dy peshkatarë në çdo mjet lundrues.

Në këtë lagunë peshkimi i ngjalës nga grupet e peshkimit kryhet në formën e peshkimit artizanal me dajlan dhe në formën e peshkimit artizanal me paranca (rreth 200 paranca).

Tabela 10. Zëniet e ngjalës sipas formave të peshkimit në vite

Viti	**Zëniet sipas veglës të përdorur (ton)**				**Zëniet sipas dimensioneve (g)**		
	Dajlan	**Paranca**	**Grepa**	**Totali**	**80-100**	**100-300**	**>300**
2013	0,30	2,53	0,00	2,83	35%	55%	10%
2014	0,29	1,07	0,00	1,36	35%	55%	10%
2015	0,50	2,10	0,00	2,60	35%	55%	10%
2016	0,19	1,10	0,00	1,29	35%	55%	10%
2017	0,20	0,40	0,00	0,60	35%	55%	10%
2018	0,27	1,76	0,00	2,03	35%	55%	10%
Totali	**1,75**	**8,96**	**0,00**	**10,71**			



LAGUNA E KARAVASTASË

Laguna e Karavastasë (zonë Ramsar) është përfshirë në mozaikët më të ndryshëm të habitateve bregdetare në Shqipëri që shtrihen midis lumit Shkumbin dhe Seman, në pjesën qendrore të bregdetit shqiptar të Adriatikut. Laguna e Karavasta përfshihet në zonën komplekse Karavasta me lagunën e Godullës, dhe kolektorët e ujitjes të Myzeqe dhe Tërbufit, zona e Kularit dhe lumi Seman e Shkumbin në të dy anët e lagunës.

Sipërfaqja (ha)	**Gjatësia max (m)**	**Gjerësia max (m)**	**Thellësia max. (m)**	**Thellësia mesatare (m)**
4100	10600	43800	1,3	0,7

Laguna e Karavasta është e lidhur me detin përmes tri kanaleve:
Verior - e gjatë 700m; 17 m i gjerë dhe 0,75m i thellë;
Qendror - e gjatë 1200m; 26 m i gjerë dhe 1.55m i thellë;
Jugor - i gjatë 500m; 23m e gjerë dhe 0,61m i thellë.

Vetëm kanali verior është i lidhur drejtpërdrejt me detin, por është e nevojshme ta hidhni atë. Të tjerët komunikojnë me Godullën. Në perëndim të lagunës e cila tashmë ka marrë formën e

një lagune të re (laguna Godulla) me një sipërfaqe prej 650 ha, gjatësi 5 km, 3,8 km gjerësi dhe një thellësi maksimale prej 3.1 m, e lidhur me detin nga dy kanale të tjera. Në pjesën veriore të lagunës së Karavastasë, afër daljes së lumit Shkumbin, ndodhet një lagunë tjetër shumë e vogël (Godulla Veriore). Futja e ujit të ëmbël në lagunë është mjaft e pakët.

Proceset hidrogeomorfologjike në lagunë, konsistojnë në: shtrirje të rrjetit hidrografik, aluvione të ngurta të lumenjve Seman dhe Shkumbin dhe perplasje të valëve të detit Adriatik. Kjo zonë është e përbërë kryesisht nga depozitat me rërë dhe argjilë të kuaternarit. Në jug të grykës së Shkumbinit paralelisht me detin ranor dhe me rërë deti ndodhen depozitat kuaternare, dhe rreth e rrotull lagunës së Karavasta, depozita me moçal me balte dhe nën argjilë, nën rërë dhe torfe (tufë) të epokës kuaternare. Midis kodrave të Divjakës, lumit Shkumbin në veri dhe lumit Seman në jug ka depozita të argjilës kuaternare aluvionale, nën argjilë dhe nën rërë. Anët malore perëndimore të kodrave të Divjakës formohen nga rëra aleurite, dhe konglomeratet e epokës së pelocenit. Pjesa qendrore e lagunës së Karavastasë karakterizohet nga një shtresë e paktë që në zonën periferike kufizohet me torfe, rërë, nën rërë dhe nën argjilë. Kjo zonë është e varfër me ujërat nëntokësore.

Iktiofauna përfaqësohet nga specie eurihaline dhe euritermike, ndër të cilat më të zakonshmet janë: *Mugil cephalus, Liza ramada, L. aurata, L. saliens, Chelos labrosus, Anguilla anguilla, Atherina hepsetus, Dicentrarchus labrax, Sparus auratus, Gobius bucchichii Aucata*. Komuniteti i peshkut në lagunat Karavasta dhe Godull përbëhet në dy grupe specie: peshqit migratorë dhe që qëndrojnë në laguna. *Sparidae, Mugilidae, Moronidae, Soleidae, Anguillidae, Belonidae* janë grupet kryesore të specieve migratore dhe *Gobiidae, Cyprinodontidae, Atherinidae, Syngnthidae* janë grupet kryesore me specie që qëndrojnë në laguna, megjithëse disa lloje të këtyre grupeve janë, gjithashtu, migratore. Në lagunën e Karavasta, veçanërisht në zonën e cekët, nga skajet deri në 0.6 m të thellë, gjatë shtrirjes (madhësia e rrjetës 1 mm) në fillim të qershorit (Crivelli, A .1996) për kapjen e peshkut të vogël, specia mbizotëruese ishte *Aphanius fasciarus*, tipike për zonat e mbyllura dhe për habitatin e degraduar (të pasura me lëndë organike). Ajo u pasua në numër nga *Atherina boyeri*. Pastaj, nga *Mugil spp*, peshku gjilpërë (*Syngnathus spp*), gobies (*Gobius bucchichi*) dhe gaforret. Më të rralla ishin *Belone belone* dhe karkalecat (*Palaemon seratus*). Në Godull, pamja është dukshëm e ndryshme, Atherina është më e bollshme me *Mugil spp. Aphanius, gobies*, levrek, shojzë, peshku gjilpërë, gaforret dhe karkalecat ishin mjaft të zakonshme.

Në vetë lagunën dhe përreth saj zënia vjetore e peshkut arrinte në 150–250 tonë/vit nga të cilat 20–30% janë qefujt, 60% ngjala, 10%, koce dhe levrek dhe 10%, të tjera specie. Në fakt, kapja vjetore vlerësohet rreth 50 tonë/vit. Në vitet e kaluara, vitet 1980, në këtë zonë praktikohet peshkimi i molusqeve, *vongola verace, Ruditapes decussatus*, me një kapje vjetore prej 60–70 tonë.

Lloji i peshkimit	**(%) e peshkut të zënë**
Dajlani	40 – 50
Peshkimi me rrjeta	30 – 40
Paranca	20

Tabela 11. Emrat e zakonshëm dhe shkencorë të peshqve të lagunës së Karavastasë

Emri anglisht	**Emri shqip**	**Emri shkencor**
Flathead grey mullet	Gushtak; Qefull vere; Cumër	Mugil cephalus
Thicklip grey mullet	Vijoshi; Vruta	Chelon labrosus
Thinlip mullet	Qefulli i vjeshtës; Kokllani; Kryegjati	Liza ramada
Leaping mullet	Vesh verdhi; Gasturi	Liza saliens
European seabass	Levrek	Dicentrarchus labrax
European eel	Ngjalë	Anguilla anguilla
Gilthead seabream	Koce	Sparus aurata
Bogue	Vope	Bops bops
White seabream	Sargua, Shpalcë	Diplodus sargus sargus

Common sole	Gjuhëz kanali; Shojze	Solea vulgaris
Mediterranean sand smelt	Aterina	Atherina hepsetus
Pipefish	Gjilpërëza	Syngngathus sp
Buccich's goby	Burdullak	Gobius bucchichi

STATUSI I PESHKIMIT I ZONËS

Në lagunën e Karavastasë zhvillon aktivitetin e saj të peshkimit Organizata e Menaxhimit të Peshkimit (OMP), Divjakë, Lushnjë. OMP Divjakë është regjistruar në regjistrin e organizatave jo fitim prurëse me vendimin nr. 3859, datë 13.5.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në Divjakë, Lushnjë.

Kjo OMP është e pajisur nga Ministria, me kontratën për zhvillimin e aktivitetit të peshkimit artizanal me dajlan nr. 3777, datë 28.5.2014. Kjo lagunë është shpallur Zonë Bashkëmenaxhuese Peshkimi me VKM nr. 238, datë 23.4.2014 të Këshillit të Ministrave.

Në lagunën e Karavastasë (Divjakë), OMP "Laguna e Divjakës" Lushnjë, e zhvillon aktivitetin e peshkimit kryesisht në formën e peshkimit artizanal me dajlan, peshkim artizanal me vallkonj të bashkuar (vendosen prapa dajlanit duke zënë gjithë gjerësinë e kanalit që lidh detin me lagunën), si dhe peshkim artizanal me mrezhda dhe njica.

Për kryerjen e aktivitetit të peshkimit artizanal me rrjeta peshkimi, janë angazhuar 10 grupe gjuetie peshku me 10 barka peshkimi me rreth 20 peshkatarë që ushtrojnë aktivitet peshkimi gjithë vjetor.

Këto grupe peshkimi, përdorin kryesisht rrjeta të tipit mrezhda me rrethim por dhe njica, rreth 3–4 copë për çdo grup gjuetie (1 mrezhdeë/njicë ka gjatësinë rreth 50–60 ml), pra do të përdoren rreth 1500–2000 ml rrjeta gjuetie.

Aktivitetin e peshkimit artizanal me dajlan e kryejnë aktualisht tri grupe peshkimi me tre dajlanë. Në dy dajlanë punojnë nga gjashtë peshkatare (3 turne x 2 peshkatarë) me 3 barka peshkimi, ndërsa në dajlanin e madh punojnë 10 peshkatarë me 5 barka peshkimi (për periudhën 6 maj–4 mars të çdo viti).

Ngjala nga grupet e peshkimit kapet në formën e peshkimit artizanal me dajlan dhe me pinarë të bashkuar (vendosen prapa dajlanit duke zënë gjithë gjerësinë e kanalit që lidh detin me lagunën), ku në dy kanalet e dajlanëve të vegjël vendosen rreth 11–12 pinar/paranca/vallkonj, ndërsa në kanalin e dajlanit kryesor vendosen rreth 30–40 pinar ngjale.

Ngjala nga grupet e peshkimit kapet në formën e peshkimit artizanal me dajlan dhe me pinarë të bashkuar (vendosen prapa dajlanit duke zënë gjithë gjerësinë e kanalit që lidh detin me lagunën), ku në 2 kanalet e dajlanëve të vegjël vendosen rreth 25–30 paranca, ndërsa në kanalin e dajlanit kryesor vendosen rreth 70 paranca ngjale.

Tabela 12. Zëniet e ngjalës sipas formave të peshkimit në vite

Viti	**Zëniet sipas veglës të përdorur (ton)**				**Zëniet sipas dimensioneve (g)**		
	Dajlan	**Paranca**	**Grepa**	**Totali**	**80-100**	**100-300**	**>300**
2013	6,77	5,80	0	12,57	20%	65%	15%
2014	6,90	5,16	0	12,06	20%	65%	15%
2015	8,10	6,19	0	14,29	20%	65%	15%
2016	5,58	5,10	0	10,68	20%	65%	15%
2017	5,10	3,10	0	8,20	20%	65%	15%
2018	6,56	5,72	0	12,28	20%	65%	15%
Totali	**39,01**	**31,07**	**0,00**	**70,08**			



LAGUNA E NARTËS

Laguna e Nartës ndodhet në pjesën veriperëndimore të Vlorës, deti Adriatik. Zgjerohet midis koordinatave gjeografike 40 ° 32" dhe 19 ° 28".

Sipërfaqja (ha)	Gjatësia max (m)	Gjerësia max (m)	Thellësia max. (m)	Thellësia mesatare (m)
2670	N/a	N/a	0,9	0,7

Narta është një nga lagunat më të mëdha në Shqipëri me një sipërfaqe prej 2670 ha. Thellësia maksimale është 0.9 m me një mesatare prej 0.7 m. Ajo është e lidhur me detin përmes dy kanaleve që duhet të mirëmbahen në intervale të rregullta. Kanali kryesor ndodhet në pjesën perëndimore të lagunës dhe ka dimensionet: 960 m gjatësi, 20m gjerësi dhe thellësi 0.8m. Kanali i dytë është në pjesën jugperëndimore të lagunës dhe ka gjatësi 120 m, gjerësi 15 m dhe thellësi 0,5 m.

Një rrip aluvional (dunat e rërës, 500ha) ndan lagunën nga deti. Në pjesën veriore dhe lindore kufizohet me tokat e kripura (500 ha). Në jug dhe perëndim–jug kufizohet me kodra, pjesërisht të mbjella me prodhime bujqësore. Po ashtu, në pjesën jugperëndimore, ekziston një pyll pishe mesdhetar dhe në lagunë ka dy ishuj: ai më i madh (ishulli Zvernec) është i mbuluar nga pemë selvi (*Cupressus sempervirens*) dhe ka në të një manastir të vogël dhe interesant.

Shkëmbimi i ujit me detin bëhet përmes një kanali me shpejtesi të ujit (1-5 m^3/sek) gjatë baticës. Për shkak të zvogëlimit të shkëmbimit të ujit, thellësisë së vogël, si dhe avullimit intensiv sipërfaqja ujore e lagunës zvogëlohet deri në 30% gjatë sezonit të thatë të vitit.

Kompleksi i lagunës së Nartës përfshin disa lloje të habitateve:

- tokë e kripur (jo në përdorim) (500ha);
- dunat e rërës;
- tokë bujqësore në lindje të lagunës (500ha);
- ligatinat bregdetare (20ha).

Laguna e Nartës paraqet një sistem kompleks nga pikëpamja hidrogeomorfologjike. Proceset hidrogeomorfologjike në lagunë janë shtrirje e rrjetit hidrografik; aluvione të ngurta të lumenjve të vegjël të ndryshëm kryesisht gjatë periudhës së dimrit; thyerje të valëve të detit Adriatik. Procesi kryesor gjeomorfologjik është akumulimi dhe depozitimi i rërës kryesisht nga brenda dhe nga deti. Narta është një lagunë tipike bregdetare dhe siç përshkruhet më lart ajo lidhet me detin përmes dy kanaleve hyrëse, të cilat deri në vitin 1966 mbulonin një sipërfaqe prej 4180 ha. Që atëherë, 1290 ha janë shndërruar në kripore për qëllime komerciale. Pellgu ujëmbledhës i lagunës mbulon rreth 7300 ha.

Lloji i peshkimit	(%) e peshkut të zënë
dajlani	60
peshkimi me rrjeta	30

paranca	10

Emri i specieve	**Përqindja në zëniet vjetore (%)**
Qefull	40
Koce dhe levrek	25
Ngjala	25
Aterina	10

Tabela 13. Emrat e zakonshëm dhe shkencorë të peshqve të lagunës së Nartës

Emri anglisht	**Emri shqip**	**Emri shkencor**
Flathead grey mullet	Gushtak; Qefull vere; Cumër	*Mugil cephalus*
Thicklip grey mullet	Vijoshi; Vruta	*Chelon labrosus*
Thinlip mullet	Qefulli i vjeshtës; Kokllani; Kryegjati	*Liza ramada*
Leaping mullet	Vesh verdhi; Gasturi	*Liza saliens*
European seabass	Levrek	*Dicentrarchus labrax*
European eel	Ngjalë	*Anguilla anguilla*
Gilthead seabream	Koce	*Sparus aurata*
Bogue	Vope	*Bops bops*
White seabream	Sargua, Shpalcë	*Diplodus sargus sargus*
Common sole	Gjuhëz kanali; Shojze	*Solea vulgaris*
Mediterranean sand smelt	Aterina	*Atherina hepsetus*
Pipefish	Gjilpërëza	*Syngngathus sp*
Buccich's goby	Burdullak	*Gobius bucchichi*

STATUSI I PESHKIMIT I ZONËS

Në lagunën e Nartës zhvillon aktivitetin e saj Organizata e Menaxhimit të Peshkimit (OMP), Nartë. Kjo OMP është krijuar më datë 21.3.2007 dhe miratuar me Urdhrin e MBU nr. 17/4, datë 16.12.2007 "Për miratimin e Statutit të Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit (OMP e Lagunës Nartë dhe Orikum". Me aktin e themelimit të OMP Nartë është miratuar lista e Asamblesë dhe drejtuesit e saj me qendër në Nartë. Kjo organizatë ka në përbërje të saj dhe anëtarë nga subjekti i peshkimit me dajlan në lagunën e Orikumit, pasi kjo OMP mbulon ekosistemin lagunor Nartë–Orikum.

Kjo OMP është e pajisur nga Ministria, me Kontratën për zhvillimin e aktivitetit të peshkimit artizanal me dajlan nr. 6204, datë 9.9.2013, për zhvillimin e peshkimit në zonën bashkemenaxhuese, që përfshin objektet ujore laguna e Nartës, Limopua dhe laguna e Orikumit, të shpallur "Zonë Bashkëmenaxhuese Peshkimi" me VKM nr. 304, datë 20.4.2016 të Këshillit të Ministrave.

Ne lagunën e Nartës, zhvillon aktivitet peshkimi OMP "Laguna e Nartës", Vlorë, kryesisht në formën e peshkimit artizanal me dajlan, si dhe peshkim artizanal me mrezhda, njica, pinar dhe grepa (200-500 copë grepa për çdo subjekt peshkimi), nga rreth 30 subjekte peshkimi me 60 peshkatarë, me 30 barka peshkimi.

Për kryerjen e aktivitetit të peshkimit artizanal me rrjeta peshkimi, janë angazhuar 20 grupe gjuetie peshku me 20 barka peshkimi me rreth 40 peshkatarë që ushtrojnë aktivitet peshkimi gjithë vjetor.

Këto grupe peshkimi, sipas kontratës së mësipërme përdorin kryesisht rrjeta të tipit mbrezhda me rrethim, por dhe njica, rreth 10 njica dhe 10 mrezhda për çdo grup gjuetie (1 mrezhdë/njice ka gjatësinë rreth 50–60 ml), por aktualisht ata përdorin rreth 5–6 rrjeta të tilla, pra përdoren rreth 5 000–6 000 ml rrjeta gjuetie. Këta peshkatarë në aktivitetin e peshkimit përdorin dhe grepat e peshkimit për ngjalën, kur dajlanët janë të hapur (rreth 200–500 grepa për çdo subjekt peshkimi-linja grepash). Aktivitetin e peshkimit artizanal me dajlan e kryejnë aktualisht dy grupe peshkimi me dy dajlanë. Në dy dajlanë punojnë nga nëntë peshkatarë (3 turne x 3 peshkatarë) me

nga tri barka peshkimi secili. Ky aktivitet peshkimi zhvillohet në periudhën kohore 11 prill–9 shkurt të çdo viti).

Ngjala nga grupet e peshkimit të kësaj OMP-je kapet në formën e peshkimit artizanal me dajlan dhe me paranca të bashkuar (vendosen prapa dajlanit duke zënë gjithë gjerësinë e kanalit që lidh detin me lagunën), ku para dajlanit (në brendësi të lagunës në të 2 kanalet e 2 dajlanëve vendosen rreth 130 paranca ngjale.

Tabela 14. Zëniet e ngjalës sipas formave të peshkimit në vite

Viti	**Zëniet sipas veglës të përdorur (ton)**				**Zëniet sipas dimensioneve (g)**		
	Dajlan	**Paranca**	**Grepa**	**Totali**	**80-100**	**100-300**	**>300**
2013	4,19	3,30	0,00	7,49	35%	40%	25%
2014	5,32	3,18	0,00	8,50	35%	40%	25%
2015	6,20	3,90	0,00	10,10	35%	40%	25%
2016	4,70	3,10	0,00	7,80	35%	40%	25%
2017	3,45	2,26	0,00	5,71	35%	40%	25%
2018	3,30	3,82	0,00	7,12	35%	40%	25%
Totali	**27,16**	**19,56**	**0,00**	**46,73**			



LAGUNA E ORIKUMIT

Laguna e Orikumit ndodhet në pjesën jugperëndimore të Vlorës, në jug të Shqipërisë. Zgjerohet në mes koordinatave të gjerësisë gjeografike 40 ° 19 ' veriore dhe gjatësisë gjeografike lindore 19 ° 25'.

Sipërfaqja (ha)	**Gjatësia max (m)**	**Gjerësia max (m)**	**Thellësia max. (m)**	**Thellësia mesatare (m)**
130	n/a	n/a	3,5	2,5

Laguna e Orikumit ka një sipërfaqe prej 130 ha, ndërsa fushat e ulëta përreth fushave të Dukatit kanë një sipërfaqe prej 1000 ha. Thellësia maksimale është 3,5 m me një thellësi mesatare 2.5 m. Ajo është e lidhur me detin përmes një kanali në pjesën perëndimore të lagunës dhe dimensionet e tij janë 150 gjatësi, gjerësi 4–5m dhe thellësi 0,5m. Ky kanal i hyrjes në det funksionon rregullisht sepse erozioni është shumë i ulët dhe kanali gërryhet nga peshkatarët duke përdorur një ekskavator. Pavarësisht kësaj, një problem në kanal është zhavorri i grumbulluar atje nga valët e detit, veçanërisht kur ka erë të fortë. Një pus uji i ëmbël me shkarkime të kufizuara, 600-700 l / s, ndodhet në jug të lagunës.

Në kohën e antikitetit, vija bregdetare ishte larg vendit ku është tani. Në zonë është qyteti antik i Orikum, i cili tani është nën nivelin e ujërave të lagunës. Me kohë aluvionet nga lumenjtë e vegjël përreth dhe lëvizjet tektonike krijuan situatën e paraqitur në ditët e sotme. Para viteve 1950 sipërfaqja e lagunës ishte më shumë sesa tani. Pas procesit të bonifikimit, 400 ha nga këneta bonifikuan tokën përreth lagunës për përdorim bujqësor. Midis tokës dhe lagunës ekziston një pengesë artificiale (diga) e bërë nga zhavorri që ndalon ujin e detit sepse e gjithë zona është nën nivelin e detit, ku është aktiv një stacion pompimi që nuk lejon që ujërat e ëmbël të rrjedhin në lagunë. Për shkak të kësaj, sasia e ujit të freskët që arrin lagunën është zvogëluar, gjithashtu është zvogëluar shkëmbimi me detin dhe është ndryshuar e gjithë hidrologjia e lagunës.

Lloji i peshkimit	**(%) e peshkut të zënë**
dajlani	55
peshkimi me rrjeta	30
paranca	15

Emri i specieve	**Përqindja në zëniet vjetore (%)**
Qefuj	50
Karkalec	25
Koce dhe levrek	20
Ngjala	15

Tabela 15. Emrat e zakonshëm dhe shkencorë të peshqve të lagunës së Orikumit

Emri anglisht	**Emri shqip**	**Emri shkencor**
Flathead grey mullet	Gushtak; Qefull vere; Cumër	*Mugil cephalus*
Thicklip grey mullet	Vijoshi; Vruta	*Chelon labrosus*
Thinlip mullet	Qefulli i vjeshtës; Kokllani; Kryegjati	*Liza ramada*
Leaping mullet	Vesh verdhi; Gasturi	*Liza saliens*
European seabass	Levrek	*Dicentrarchus labrax*
European eel	Ngjalë	*Anguilla anguilla*
Gilthead seabream	Koce	*Sparus aurata*
Bogue	Vope	*Bops bops*
White seabream	Sargua, Shpalcë	*Diplodus sargus sargus*
Common sole	Gjuhëz kanali; Shojze	*Solea vulgaris*
Mediterranean sand smelt	Aterina	*Atherina hepsetus*
Pipefish	Gjilpërëza	*Syngngathus sp*
Buccich's goby	Burdullak	*Gobius bucchichi*

STATUSI I PESHKIMIT I ZONËS

Në lagunën e Orikumit zhvillon aktivitet peshkimi një subjekt peshkimi, pjesë e OMP-së "Laguna e Nartës", Vlorë, kryesisht në formën e peshkimit artizanal me dajlan, si dhe peshkim artizanal me mbrezhda, njica, pinar dhe grepa (100–200 copë grepa për çdo subjekt peshkimi), nga një subjekt peshkimi me 9 peshkatarë, me 3 barka peshkimi.

Nga ky subjekt peshkimi, për kryerjen e aktivitetit të peshkimit artizanal me rrjeta peshkimi, janë angazhuar dy grupe gjuetie peshku me dy barka peshkimi me katër peshkatarë që ushtrojnë aktivitet peshkimi gjithë vjetor.

Këto grupe peshkimi, përdorin kryesisht rrjeta të tipit mrezhda me rrethim por dhe njica, rreth 20–30 copë për çdo grup gjuetie (1 mbrezhdë/njice ka gjatësinë rreth 50–60 ml), pra do të përdoren rreth 1 000–2 000 ml rrjeta gjuetie. Këta peshkatarë në aktivitetin e peshkimit përdorin dhe grepat e peshkimit (rreth 100–150 grepa për çdo subjekt peshkimi-linja grepash).

Aktivitetin e peshkimit artizanal me dajlan e kryejnë aktualisht dy grupe peshkimi me një dajlan. Në dajlan punojnë 4–6 peshkatarë (2–3 turne x 2 peshkatarë) me një barkë peshkimi.

Ky aktivitet peshkimi zhvillohet në periudhën kohore 17 qershor–15 mars të çdo viti. Peshkatarët e kësaj lagune, janë të organizuar dhe bëjnë pjesë në OMP-në Nartë, e cila është krijuar më datë 21.3.2007 dhe miratuar me urdhrin e MBU-së nr. 17/4, datë 16.12.2007 "Për miratimin e Statutit të Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit (OMP-ja e lagunës Nartë dhe Orikum", dhe e pajisur nga Ministria, me Kontratën për zhvillimin e aktivitetit të peshkimit artizanal me dajlan nr. 6204, datë 9.9.2013, për zhvillimin e peshkimit në zonën bashkemenaxhuese, që përfshin objektet ujore laguna e Nartës, Limopua dhe laguna e Orikumit.

Ngjala nga grupet e peshkimit kapet në formën e peshkimit artizanal me dajlan dhe në formën e peshkimit artizanal me paranca (me rreth 50 copë paranca).

Tabela 16. Zëniet e ngjalës sipas formave të peshkimit në vite

Viti	**Zëniet sipas veglës të përdorur (ton)**				**Zëniet sipas dimensioneve (g)**		
	Dajlan	**Paranca**	**Grepa**	**Totali**	**80-100**	**100-300**	**>300**
2013	0,52	0,60	0,00	1,13	35%	50%	15%
2014	0,64	0,52	0,00	1,16	35%	50%	15%
2015	1,10	0,90	0,00	2,00	35%	50%	15%
2016	0,78	0,37	0,00	1,15	35%	50%	15%
2017	0,59	0,06	0,00	0,65	35%	50%	15%
2018	0,43	0,84	0,00	1,27	35%	50%	15%
Totali	**4,07**	**3,29**	**0,00**	**7,36**			



LAGUNA E BUTRINTIT

Laguna e Butrintit ndodhet në pjesën jugore të Shqipërisë. Është laguna e vetme që lidhet me detin Jon dhe për shkak të bregut specifik shkëmbor të këtij deti ka karakteristika që e bëjnë këtë lagunë të ndryshme nga lagunat e tjera.

Zona e Lagunës i përket rrethit Sarandë. Mbulon rreth 35 km vijë bregdetare dhe fillon nga 9 deri në 25 km në jug të qytetit të Sarandës. Kompleksi i Butrintit përfshin lagunën e Butrintit, liqenin Bufi, daljen e lumit Pavllo dhe lumin Bistrica. Ekziston edhe një kolektor ujitës që derdhet në lagunë. Për shkak të faktit se laguna është larg nga deti (kanali lidhës deti–laguna është e gjatë 3,6 km) Butrinti konsiderohet më shumë si një liqen sesa laguna.

Sipërfaqja (ha)	**Gjatësia max (m)**	**Gjerësia max (m)**	**Thellësia max. (m)**	**Thellësia mesatare (m)**
1600	5400	1400	21,4	11

Laguna e Butrintit ka një sipërfaqe prej 1600 ha Ajo ka një gjatësi maksimale 5.4 km dhe gjerësi 1.4 km. Thellësia maksimale është 21,4 m me një mesatare prej 11 m. Ajo është e lidhur me detin përmes një kanali, i cili ka dimensione vijuese që janë gjatësi 3.6 km, gjerësi 80 - 120m dhe thellësi 6m. Në pjesën jugperëndimore të liqenit ekziston një tjetër kanal që lidh lagunën e Butrintit me liqenin e Bufit. Ky kanal është më i vogël me gjatësi 300 m, gjerësi 12m dhe thellësi 5m.

Butrinti shtrihet pak në brendësi nga bregu lindor i ngushticës së Korfuzit, me të cilin e lidh kanali Vivari. Gjatë 3000 viteve, kanali i hyrjes së detit u mbush me materiale aluvionale të sjellë nga të dy lumenjtë, të cilët ushqeheshin nga lumenjtë (Pavllo në jug dhe Bistrica në verilindje). Ndërkohe që krijohej delta, u zhvillua një kënetë dhe vija bregdetare u tërhoq ngadalë, duke e lënë liqenin të izoluar. Deri në kohën e Cezarit, vija bregdetare ishte tërhequr shumë përtej Butrintit dhe qyteti ishte i lidhur me ngushticat e Korfuzit nga kanali Vivarit.

Mënyra më e mirë për të kuptuar shpërndarjen e tanishme të habitateve në pellgun e Butrintit është historiku i ndërhyrjeve të bëra në këtë zonë. Ekzistojnë tri aspekte kryesore nga këndvështrimi i ndërhyrjes njerëzore:

Viti 1959. Devijimi i lumit Bistrica dhe ndryshimi i rrjedhës së ujit në lagunë. Uji i Bistricës u devijua për në det përmes kanalit Cukës, kështu që laguna nuk kishte më qasje në ujërat e ëmbël. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte bonifikimi i zonave përmes kullimit të ligatinave.

- Viti 1986 - 1987. Thellimi i kanalit të Butrintit
- Viti 1988. Devijimi i kontrolluar i lumit Bistrica në lagunë. Kjo u krye përmes një kanali të ri që dha mundësinë që ujërat e ëmbël të derdhen përsëri në lagunë.

Lloji i peshkimit	**(%) e peshkut të zënë**
dajlani	70
peshkim me mbrezhda dhe njica	15
paranca	12
grepa	3

Emri i specieve	**Përqindja në zëniet vjetore (%)**
Qefuj	80
Ngjala	10
Koce dhe levrek	6
Gjuhëz	2
Të tjera	2

Tabela 17. Emrat e zakonshëm dhe shkencorë të peshqve të lagunës së Butrintit

Emri anglisht	**Emri shqip**	**Emri shkencor**
Flathead grey mullet	Gushtak; Qefull vere; Cumër	*Mugil cephalus*
Thicklip grey mullet	Vijoshi; Vruta	*Chelon labrosus*
Thinlip mullet	Qefulli i vjeshtës; Kokllani; Kryegjati	*Liza ramada*
Leaping mullet	Vesh verdhi; Gasturi	*Liza saliens*
European seabass	Levrek	*Dicentrarchus labrax*
European eel	Ngjalë	*Anguilla anguilla*
Gilthead seabream	Koce	*Sparus aurata*
Bogue	Vope	*Bops bops*
White seabream	Sargua, Shpalcë	*Diplodus sargus sargus*
Common sole	Gjuhëz kanali; Shojze	*Solea vulgaris*
Mediterranean sand smelt	Aterina	*Atherina hepsetus*
Pipefish	Gjilpërëza	*Syngngathus sp*
Buccich's goby	Burdullak	*Gobius bucchichi*

STATUSI I PESHKIMIT I ZONËS

Liqeni/laguna e Butrintit, më tepër njihet si ekosistem ujor për kultivimin ekstensiv të midhjeve, kryesisht në impiante të palëvizshme betoni (rreth 70 impiante).

Peshkimi në liqenin e Butrintit zhvillohet kryesisht në formën e peshkimit artizanal me dajlan, si dhe peshkim artizanal me mbrezhda, njica, pinarë dhe grepa, nga rreth 12 subjekte peshkimi me 40 peshkatarë, me 14 barka peshkimi.

Për kryerjen e aktivitetit të peshkimit artizanal me rrjeta peshkimi, janë angazhuar 10 grupe gjuetie peshku me 10 barka peshkimi me rreth 20 peshkatarë që ushtrojnë aktivitet peshkimi gjithë vjetor.

Këto grupe peshkimi, përdorin kryesisht rrjeta të tipit mbrezhda dhe njica, rreth 4–5 copë për çdo grup gjuetie (1 mbrezhdë/njice ka gjatësinë rreth 50–60 ml), pra do të përdoren rreth 3 000 ml rrjeta gjuetie. Këta peshkatarë në aktivitetin e peshkimit përdorin dhe grepat e peshkimit (rreth 100–200 grepa për çdo subjekt peshkimi-linja grepash).

Aktivitetin e peshkimit artizanal me dajlan e kryejnë aktualisht dy grupe peshkimi me dy dajlane. Në 2 dajlane punojnë rreth 16 peshkatarë (3 turne x 3 peshkatarë) me nga 2 barka peshkimi secili. Ky aktivitet peshkimi zhvillohet në periudhën kohore 1 korrik–30 mars të çdo viti për dajlanin e Vivarit (Butrintit) dhe nga 16 qershori–14 prilli të çdo viti për dajlanin e Pritës së Rrezës).

Ngjala nga grupet e peshkimit kapet në formën e peshkimit artizanal me dajlan dhe në formën e peshkimit artizanal me paranca (me rreth 50 copë paranca).

Tabela 18. Zëniet e ngjalës sipas formave të peshkimit në vite liqeni Butrintit–Prita e Rrezës

Viti	Zëniet sipas veglës të përdorur (ton)				Zëniet sipas dimensioneve (g)		
	Dajlan	Paranca	Grepa	Totali	80-100	100-300	>300
2013	0,73	1,37	0,00	2,10	25%	65%	10%
2014	0,40	1,05	0,00	1,45	25%	65%	10%
2015	0,90	2,00	0,00	2,90	25%	65%	10%
2016	0,56	1,37	0,00	1,93	25%	65%	10%
2017	0,48	0,60	0,00	1,08	25%	65%	10%
2018	0,56	1,85	0,00	2,42	25%	65%	10%
Totali	3,64	8,24	0,00	11,88			



Tabela 19. Zëniet e ngjalës sipas formave të peshkimit në vite liqeni Butrintit–Vivar

Viti	Zëniet sipas veglës të përdorur (ton)	Zëniet sipas dimensioneve (g)

	Dajlan	Pinar	Grepa	Totali	80-100	100-300	>300
2013	0,71	0,07	0,00	0,78	35%	60%	5%
2014	0,06	0,03	0,00	0,08	35%	60%	5%
2015	0,90	0,10	0,00	1,00	35%	60%	5%
2016	0,08	0,02	0,00	0,10	35%	60%	5%
2017	0,60	0,00	0,00	0,61	35%	60%	5%
2018	0,07	0,04	0,00	0,12	35%	60%	5%
Totali	**2,42**	**0,27**	**0,00**	**2,69**			



MASAT MENAXHUESE

Ky plan menaxhimi përcakton kushtet për zhvillimin e aktivitetit të peshkimit të ngjalës në lagunat bregdetare dhe ujërat e brendshme shqiptare, si dhe të kontrollit të zbatimit të tij nga ana e Inspektoratit të Peshkimit.

Seksioni I
Dimensionet e lejuara të peshkimit të ngjalës

Duke filluar nga data 1 nëntor 2019 dimensionet e lejuara të peshkimit të ngjalës janë sipas tabelës së më poshtme.

Zona	2019 cm	2020 cm	2021 cm	2022 cm	2023 cm	2024 cm
Lagunat bregdetare dhe ujërat e brendshme	30	35	36	38	39	40

Seksioni II
Sasitë e ngjalës së argjendtë që lëshohen (faza e të rriturve që ndërmerr migrimin riprodhues) në det

Metodologjia e llogaritjes: 10%, 20%, 30% dhe 40 % e mesatares së 5 viteve të fundit.

1. Liqeni i Shkodrës

a) Sasia e ngjalës së argjendtë që do të lëshohet sipas viteve nga dajlani Shkodër.

Vitet	**2019**	**2020**	**2021**	**2022**	**2023**
Sasia ton që lëshohet	0.91	1.83	2.74	3.65	3.65

2. Laguna e Vilunit

a) Sasia e ngjalës së argjendtë që do të lëshohet sipas viteve nga laguna e Vilunit.

Vitet	**2019**	**2020**	**2021**	**2022**	**2023**
Sasia ton që lëshohet	0.34	0.69	1.03	1.37	1.37

3. Laguna e Vainit

a) Sasia e ngjalës së argjendtë që do të lëshohet sipas viteve nga laguna e Vainit.

Vitet	**2019**	**2020**	**2021**	**2022**	**2023**
Sasia ton që lëshohet	0.79	1.6	2.4	3.2	3.2

4. Laguna e Kunes

a) Sasia e ngjalës së argjendtë që do të lëshohet sipas viteve nga laguna e Kunes.

Vitet	**2019**	**2020**	**2021**	**2022**	**2023**
Sasia ton që lëshohet	0.26	0.51	0.76	1.02	1.02

5. Laguna e Patokut

a) Sasia e ngjalës së argjendtë që do të lëshohet sipas viteve nga laguna e Patokut.

Vitet	**2019**	**2020**	**2021**	**2022**	**2023**
Sasia ton që lëshohet	0.17	0,36	0.53	0.71	0.71

6. Laguna e Karavastasë

a) Sasia e ngjalës së argjendtë që do të lëshohet sipas viteve nga laguna e Karavastasë.

Vitet	**2019**	**2020**	**2021**	**2022**	**2023**
Sasia ton që lëshohet	1.17	2.34	3.5	4.67	4.67

7. Laguna e Nartës

a) Sasia e ngjalës së argjendtë që do të lëshohet sipas viteve nga laguna e Nartës

Vitet	**2019**	**2020**	**2021**	**2022**	**2023**
Sasia ton që lëshohet	0.78	1.56	2.33	3.12	3.12

8. Laguna Orikumit

a) Sasia e ngjalës së argjendtë që do të lëshohet sipas viteve nga laguna e Orikumit

Vitet	**2019**	**2020**	**2021**	**2022**	**2023**
Sasia ton që lëshohet	0.12	0.25	0.37	0.5	0.5

9. Laguna e Butrintit Prita e Rrezës

a) Sasia e ngjalës së argjendtë që do të lëshohet sipas viteve nga laguna e Butrintit Prita e Rrëzës.

Vitet	**2019**	**2020**	**2021**	**2022**	**2023**
Sasia ton që lëshohet	0.2	0.4	0.6	0.8	0.8

9/1. Laguna e Butrintit Vivar

a) Sasia e ngjalës së argjendtë që do të lëshohet sipas viteve nga laguna e Butrintit **Vivar**

Vitet	**2019**	**2020**	**2021**	**2022**	**2023**
Sasia ton që lëshohet	0.045	0.089	0.13	0.18	0.18

10. Vetëm pasi të jetë plotësuar sasia e lëshimit të ngjalës së argjendtë të përcaktuar sipas këtij plani pjesa tjetër e zënë e ngjalës do të administrohet nga subjektet e peshkimit.

Seksioni III
Kufizimet në lidhje me mjetet e peshkimit

I. Ndalohet vendosja e rraçave mbas dajlanit.

II. Ndalimi sipas kategorive ujore.

1. Liqeni i Shkodrës

a) Në liqenin e Shkodrës lejohet vetëm 1 rresht pinarësh me gjatësi 250 ml, për periudhën 15 shtator–31 dhjetor në vartësi të OMP-së Shkodër. Deri më 31 dhjetor 2019 lejohen tre rreshta pinarësh.

b) Lejohet peshkimi me grepa për ngjalën me maksimumin e 50 subjekteve/vit për periudhën 1 prill–30 qershor.

2. Reduktimi me 60% i mjeteve të peshkimit stacionar (Paranca) sipas zonave të peshkimit (lagunave).

a) Në të gjitha lagunat ndalohet vendosja e racave mbas Dajlanit.

b) Numri i lejuar i mjeteve të peshkimit sipas zonave ujore sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Emri i lagunës	Nr. i parancave të lejuara
1	**Laguna e Vilunit**	**60**
2	**Laguna e Vainit**	**28**
3	**Laguna e Kune**	**120**
	Laguna e Merxhanit (zona ujore verilindore Ura e Merxhanit)	48
	Laguna e Merxhanit (zona ujore jugperëndimore Gjerdaf)	36
	Njësia lagunore "Gjoli i Knallës"	18
	Njësia lagunore "Vija Kular"	18
4	**Laguna e Patokut**	**80**
	Laguna veriore (djathtas rrugës kur hyn në lagunë) dhe paralaguna	20
	Laguna jugore (zona ujore nga rruga automobilistike deri dajlani i subjektit juridik "Martinaj" sh.p.k.	30
	Laguna jugore (nga dajlani i subjektit juridik "Martinaj" sh.p.k. deri te kanali i hidrovorit Shëllinza dhe lumi i Drojës)	30
5	**Laguna e Karavastasë**	**40**
	Numri i parancave në lagunën e Karavastasë në dajlanin kryesorë	28
	Numri i parancave në lagunën e Karavastasë në dy dajlanët e vegjël	12
6	**Laguna e Nartës**	**52**
	Dajlani nr. 1	5
	Dajlani nr. 2	4
	Barkat e tjera të peshkimit (çdo peshkatarë anëtarë i OMP nga 1 parancë ose çdo barkë peshkimi nga 2 paranca).	43
7	**Laguna Orikumit**	**20**
8	**Laguna e Butrintit**	**20**
	Dajlani i Vivarit	10
	Dajlani i Pritës së Rrezë	10

Seksioni IV
Kontrolli dhe mënyra e zbatimit të planit

Kontrolli dhe zbatimi i masave menaxhuese të vendosura në këtë plan menaxhimi do të jenë të renditura si më poshtë:

1. Për garantimin e sasisë së lëshuar të ngjalës së argjendtë e përcaktuar sipas këtij plani ngrihet një grup pune i përbërë nga: inspektori i zonës së peshkimit, përgjegjësi i Inspektoratit të

Peshkimit dhe një përfaqësues nga sektori i programeve të zhvillimit në fushën e peshkimit dhe akuakulturës pranë Ministrisë së Bujqësisë Zhvillimit Rural.

2. Subjekti i peshkimit njofton minimumi 24 orë përpara inspektorin e zonës së peshkimit për orën dhe datën e lëshimit të sasisë së ngjalës së argjendtë kjo e pjesshme apo e plotë.

3. Subjektet që do të lëshojnë ngjalën e argjendtë transportojnë ngjalën në pjesën e jashtme të dajlanit dhe më pas bëhet lëshimi i tyre.

4. Përpara fillimit të lëshimit të ngjalës së argjendtë bëhet vlerësimi i sasisë së ngjalës e cila është e destinuar për t'u lëshuar.

5. Në përfundim të procesit të lëshimit nënshkruhet procesverbali nga subjekti peshkues dhe anëtarët e grupit të punës, në të cilin duhet të përcaktohet: ora, data, sasia e ngjalës së argjendtë të lëshuar.

6. Në zbatim të pikës 11, të nenit 5 të "Kontratës për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit artizanal lagunor", subjektet e peshkimit artizanal lagunor apo Organizatat e Menaxhimit të Peshkimit duhet të zbatojnë çdo dispozitë të re ligjore ose ndryshim të dispozitave ligjore ekzistuese në fushën e peshkimit dhe/apo mjedisore.

7. Mosrespektimi i lëshimit të sasisë së përcaktuar sipas këtij plan menaxhimi përbën kusht për zgjidhjen e kontratës së lidhur midis subjekteve të peshkimit artizanal lagunor ose Organizatave Menaxhuese Peshkimit me MBZHR-në.